



VROJTIM

MBI

**GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E
NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI**

Shënim metodologjik dhe pyetësor

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

PËRMBAJTJA

1. Karakteristika të përgjithshme	3
2. Motivimi për organizimin e vrojtimit	3
3. Karakteristikat e përgjithshme të pyetësorit	4
4. Hedhja në terren dhe rezultatet e pyetësorit.....	4
Aneks I.....	6

1. Karakteristika të përgjithshme

Vrojtimet në terren të grupeve të caktuara për qëllime të ndryshme studimore, janë bërë tashmë një mjet i përdorur gjerësisht nga bankat qendrore, përmes të cilave realizohet marrja, në kohë reale, e atij lloji informacioni që është i vështirë të përfshihet në të dhënat zyrtare. Banka e Shqipërisë prej vitesh zhvillon me sukses disa vrojtime, të cilat sigurojnë një informacion të gjerë, kryesisht cilësor dhe më rrallë sasior, mbi agjentë të ndryshëm ekonomikë, në lidhje me zhvillime të kaluara, aktuale apo të pritshme. Rezultatet e këtyre vrojtimeve përdoren vazhdimisht nga Banka e Shqipërisë në analiza e raporte periodike, krahas statistikave zyrtare.

Nga viti 2010, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, Banka e Shqipërisë ka kryer vrojtime me frekuencë gjashtëmujore, mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve, me synim vlerësimin e aspekteve të ndryshme të aktivitetit financiar të tyre. Pyetësori përbëhet nga pyetje sasimore dhe cilësore, me qëllim marrjen e të dhënave sasimore nga të intervistuarit, si edhe të opinioneve mbi huamarrjen e tyre në të kaluarën, së bashku me pritshmëritë për të ardhmen.

2. Motivimi për organizimin e vroitimit

Monitorimi i ecurisë së sistemit financiar në vend nga Banka e Shqipërisë, bëhet duke u nisur nga të dhënat e marra në formën e raportimeve nga institucionet financiare bankare dhe jobankare. Pjesa e të dhënave mbi huadhënien për ekonominë, pavarësisht nivelit të detajuar të tyre, lejon një analizim të situatës me fokus në sektorin bankar, pra gjithnjë në drejtimin bankë-sektor privat. Për këtë arsye, është e vështirë të krijohet një ide e plotë mbi këtë marrëdhënie dhe ndikimin e saj në ekonominë e vendit.

Është mjaft me interes për Bankën e Shqipërisë që përmes vroitimit të një kampioni përfaqësues ndërmarrjesh, të mbledhë informacion sasior dhe cilësor mbi disa aspekte që nuk përfshihen në raportimet e bankave apo statistika të tjera zyrtare si: aftësinë paguese të ndërmarrjeve në vend; marrëdhënien e tyre me bankat; karakteristikat e huamarrjes; aksesin në financim; përputhshmërinë me kredidhënien nga institucionet financiare në vend; koston e shërbimit të huasë, në raport me gjendjen financiare të ndërmarrjeve; prirjet për të ardhmen, lidhur me investimet dhe huamarrjen etj. Vrojtime të tilla janë gjerësisht të përdorura edhe nga banka të tjera qendrore, si Banka e Italisë, Banka e Anglisë etj. dhe shpeshherë përmbajnë pyetësorë tepër të detajuar për ecurinë financiare të ndërmarrjeve.

Informacioni i mbledhur nga vrojtimi përpunohet për të nxjerrë në mënyrë indirekte rezultate mbi rreziqet që mund t'i kanosen sistemit financiar nga sektori privat në vend. Gjithashtu, synohet të ndërtohen tregues të ndryshëm në nivel sektori të ekonomisë apo sipas madhësisë së ndërmarrjeve, të cilat do të shërbejnë për të ndjekur aspekte të veçanta të huamarrjes së ndërmarrjeve në vend. Në përgjithësi, informacioni i mbledhur nga ky vërtetim shërben për të plotësuar dhe thelluar më tej analizat që realizohen aktualisht nga Departamenti i Stabilitetit Financiar, duke krijuar një kuadër më të qartë të situatës.

3. Karakteristikat e përgjithshme të pyetësorit

Pyetësori mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve përbëhet nga 35 pyetje të organizuara në 5 rubrika, si më poshtë:

- organizimi dhe fusha e veprimit;
- ecuria financiare e ndërmarrjes dhe prania e huasë;
- struktura e huasë;
- ngarkesa e huasë;
- marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen

Pyetjet në pyetësor mbulojnë tre periudha të ndryshme kohore (gjashtëmujori i kaluar, periudha aktuale e plotësimit të pyetësorit dhe gjashtëmujori pasardhës), duke mundësuar krijimin e një vazhdimësie të dhënash, si edhe kryerjen e parashikimeve, lidhur me huamarrjen e këtij agjenti ekonomik.

Në mënyrë të detajuar, pyetjet e secilës rubrikë gjenden në **Aneksin I**.

4. Hedhja në terren dhe rezultatet e pyetësorit

Ky vërtetim organizohet dy herë në vit, përkatësisht në muajt qershor dhe dhjetor të çdo viti. Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar me INSTAT-in për përcaktimin e karakteristikave të kampionit dhe shtrirjen gjeografike të tij, si edhe për anketimin në terren të kampionit të përzgjedhur.

Kampioni përbëhet prej 1200 ndërmarrjesh në pronësi private, dhe mbulon sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Fillimisht, ky vërtetim u hodh në terren për një total prej 700 ndërmarrjesh të mëdha e të mesme, më një kampion të përzgjedhur me 700 ndërmarrjet me *turnover*-in më të lartë. Më tej, në vitin 2016, ai u përmirësua me një kampion të zgjeruar prej rreth 1200 ndërmarrjesh të të gjitha përmasave, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin. Kampioni është pothuajse i fiksuar,

dhe rishikohet për të përjashtuar ato biznese që nuk përgjigjen apo kanë mbyllur aktivitetin e tyre, për t'u zëvendësuar me biznese të ngjashme në madhësi dhe në natyrën e aktivitetit ekonomik.

Mbledhja e përgjigjeve realizohet përmes një procesi intervistimi ballë për ballë, midis intervistuesit dhe një personi kompetent mbi pasqyrat financiare të ndërmarrjes. Pyetjet iu drejtohen të intervistuarve, në mënyrë që ata të japin opinionin e tyre në lidhje me situatën aktuale, krahasuar me atë të gjashtëmujorit paraardhës, apo edhe të gjashtëmujorit të ardhshëm.

Hedhja e të dhënave të vrojtimit kryhet nga Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë, sipas një formati të hartuar paraprakisht nga specialistët e Departamentit të Stabilitetit Financiar. Përpunimi i të dhënave dhe analiza e rezultateve realizohen nga Departamenti i Stabilitetit Financiar. Analiza e të dhënave të këtyre pyetësorëve shërben për të identifikuar rreziqe që burojnë nga sektori privat, rëndësinë e tyre dhe zhvillimin e tyre në kohë.

Përdorimi në mënyrë të vazhdueshme i rezultateve të këtyre vrojtimeve siguron ndërtimin e serive kohore, të cilat jo vetëm plotësojnë bashkësinë e të dhënave zyrtare ekzistuese, por edhe mundësojnë ndërtimin e treguesve të ndryshëm. Këto të dhëna janë të nevojshme në përgatitjen e analizave ekonomike dhe në parashikimin e prirjeve në të ardhmen, duke ndihmuar procesin e vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë.

Ky vrojtim mund të jetë subjekt ndryshimesh sipas nevojës, me qëllim përshtatjen me praktikën më të mira, rritjen e cilësisë së informacionit të mbledhur dhe përmirësimin e mëtejshëm të analizës së zhvillimeve të aktivitetit huadhënës në këndvështrimin e ndërmarrjeve.

Aneks I.

PYETËSOR MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE

RUBRIKA I: ORGANIZIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

P1. Të dhëna të përgjithshme të ndërmarrjes:

Emri i ndërmarrjes _____
NIPT _____
Emri i presidentit _____
Personi i kontaktit _____
Rrethi _____
Adresa _____
Viti i fillimit të veprimtarisë _____

Indikatori i përgjigjes 1. përgjigjur 2. refuzuar 3. pa kontakt 4. pasive (fjetur) 5. mbyllur (çregjistruar)

P2. Sektori i ekonomisë të cilit i përket biznesi juaj? (nëse ka më shumë se një mundësi, zgjidhni vetëm alternativën me peshën më të madhe në aktivitetin tuaj)

- | | |
|-------------------------|-----------------------------|
| 1. Sektori i industrisë | 3. Sektori i ndërtimit |
| 2. Sektor i shërbimeve | 4. Sektori i tregtisë |
| | 5. Tjetër _____ (specifiko) |

P3. Sa është numri i përgjithshëm i personave të punësuar në biznesin tuaj? (një alternativë)

- | | |
|----------------------|------------------------|
| 1. 5-19 të punësuar | 4. 80-249 të punësuar |
| 2. 20-49 të punësuar | 5. Mbi 250 të punësuar |
| 3. 50-79 të punësuar | |

P4. Sa për qind të lëndës së parë e siguron brenda vendit? (një alternativë)

- | | |
|----------------|------------|
| 1. Deri në 20% | 3. 50-80% |
| 2. 20-50% | 4. Mbi 80% |

P5. Sa për qind të produkteve tuaja shiten brenda vendit? (një alternativë)

- | | |
|----------------|------------|
| 1. Deri në 20% | 3. 50-80% |
| 2. 20-50% | 4. Mbi 80% |

P6. Sa të rëndësishme kanë qenë problemet e mëposhtme në gjashtëmuorin e kaluar për ndërmarrjen tuaj?

(Plotësoni secilën alternativë me shifrat nga 1 në 10, ku: 1 - "shkalla më e ulët e vështirësisë" dhe 10 - "shkalla më e lartë e vështirësisë".)

- | | |
|--|---|
| 1. Akses në financim _____ | 5. Konkurrenca _____ |
| 2. Kostoja e financimit _____ | 6. Gjetja e tregut _____ |
| 3. Disponueshmëria e stafit të kualifikuar _____ | 7. Përshtatshmëria e legjislacionit në fuqi _____ |
| 4. Kostoja e prodhimit ose e punës _____ | 8. Të tjera _____ (përcakto) _____ |

RUBRIKA II. ECURIA FINANCIARE E NDËRMARRJES DHE PRANIA E HUASË

P7. Në cilën monedhë e kryeni veprimtarinë e biznesit? (përcaktoni përafërsisht përqindjen që zënë veprimet sipas monedhave të ndryshme në totalin e veprimtarisë së bizneseve)

- | | |
|----------------|-------------------------------------|
| 1. Lekë _____% | 3. Usd _____% |
| 2. Euro _____% | 4. Tjetër _____ (përcaktoni) _____% |

P8. a) Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (një alternativë)

1. Janë rritur
2. Janë ulur
3. Nuk kanë ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojnë shitjet në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

1. Do të rriten
2. Do të ulen
3. Nuk do të ndryshojnë

P9. Sa rezultuan shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (një alternativë; shuma në lekë të reja)

1. Deri në 10 milionë lekë
2. 10-49 milionë lekë
3. 50-99 milionë lekë
4. 100-500 milionë lekë
5. Mbi 500 milionë lekë

P10. a) Si ka ndryshuar rezultati financiar në 6 muajt e fundit? (një alternativë)

1. Është rritur
2. Është ulur
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

1. Do të rritet
2. Do të ulet
3. Nuk do të ndryshojë

P11. Sa ishte rezultati financiar i biznesit tuaj në 6 muajt e fundit, në lekë (të reja)? (një alternativë)

1. Fitim: _____lekë
2. Humbje: _____lekë

P12. a) A e keni zgjeruar veprimtarinë/rritur investimet në 6 muajt e fundit? (një alternativë)

1. Është zgjeruar
2. Është ngushtuar
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

1. Do të zgjerohet
2. Do të ngushtohet
3. Nuk do të ndryshojë

P13. Si e keni financuar veprimtarinë e biznesit tuaj në 6 muajt e fundit? (më shumë se një alternativë)

1. Nga shitjet _____%
2. Nga rezervat e mbartura/rritja e kapitalit _____%
3. Hua _____%
4. Tjetër _____(përcakto) _____%

P14. A keni aktualisht hua për të paguar? (një alternativë)

1. Po (nëse po, vazhdoni në **pyetjen 15**)
2. Jo (nëse jo, vazhdoni në **pyetjen 30**)

P15. Kur e keni marrë huanë? (më shumë se një alternativë)

1. 6 muajt e fundit _____nr. i huave
2. Vitin e fundit _____nr. i huave
3. 1-5 vitet e fundit _____nr. i huave
4. Para më shumë se 5 vitesh _____nr. i huave.

P16. Plotësoni tabelën në vazhdim për çdo hua të marrë dhe ende të pashlyer nga kompania juaj.

	Huamarrje në:	Norma e interesit (në %)	Vlera e huasë <i>(vlerë e plotë në monedhën përkatëse)</i>	Monedha e huasë
	a- Bankë			
	Huamarrje a.1			
	Huamarrje a.2			
	Huamarrje a.3			
	b- Institucion Financiar Jobankë			
	Huamarrje b.1			
	Huamarrje b.2			
	Huamarrje b.3			
	c- Person fizik			
	Huamarrje c.1			
	Huamarrje c.2			
	Huamarrje c.2			
	d- Kompani të tjera			
	Huamarrje d.1			
	Huamarrje d.2			
	Huamarrje d.3			
	e- Mall i papaguar			
	Huamarrje e.1			
	Huamarrje e.2			
	Huamarrje e.3			
	f- Tjetër (specifiko burimin)			
	Huamarrje f.1			
	Huamarrje f.2			
	Huamarrje f.3			

P17. Cili është qëllimi i përdorimit të huasë? (më shumë se një alternativë)

1. Për të përballuar shpenzime korrente
2. Për të shlyer një hua më të vjetër
3. Për të kryer një investim afatgjatë
4. Tjetër _____ (përcakto)

P18. Nëse keni marrë hua për të financuar veprimtarinë, si e konsideroni (referojuni huasë ekzistuese më të madhe të ndërmarrjes; një alternativë)

1. Të përshtatshme
2. Do të doja të merrja më SHUMË
3. Do të doja të merrja më PAK

RUBRIKA III. STRUKTURA E HUASË ME TE MADHE EKZISTUESE

P19. Edhe sa kohë duhet për të shlyer vlerën e huasë më të madhe ekzistuese? (afati maksimal; një alternativë)

1. Deri në 6 muaj
2. 6-12 muaj
3. 1-3 vjet
4. 3-5 vjet
5. Mbi 5 vjet

P20. Si është përcaktuar norma e interesit të huasë më të madhe ekzistuese? (një alternativë)

1. E pandryshueshme deri në fund të afatit
2. Mund të ndryshojë çdo 3 muaj
3. Mund të ndryshojë çdo 6 muaj
4. Mund të ndryshojë çdo vit
5. Tjetër _____ (përcakto)

P21. Sa shpesh e shlyeni huanë? (një alternativë)

1. Çdo 1 muaj
2. Çdo 3 muaj
3. Çdo 6 muaj
4. Çdo 12 muaj

P22. Cili është kolaterali që keni vendosur për përfitimin e huasë? (më shumë se një alternativë)

1. Nuk ka _____nr. i huave
2. Pasuri e paluajtshme _____nr. i huave
3. Mjete financiare _____nr. i huave
4. Dorëzani, garanci _____nr. i huave
5. Të tjera _____ (përcakto) _____nr. i huave

P23. Në rast të përdorimit të kolateralit, cila është vlera totale e tij në raport me totalin e huasë të kolateralizuar? (një alternativë)

1. Deri në 50% e vlerës së huasë
2. 50-100% e vlerës së huasë
3. 100-120% e vlerës së huasë
4. Mbi 120% e vlerës së huasë

RUBRIKA IV. NGARKESA E HUASË

P24. Cila është vlera e përgjithshme e huasë në krahasim me kapitalin e ndërmarrjes suaj? (një alternativë)

1. Afërsisht sa gjysma
2. Pothuaj e njëjtë
3. Gati 2 herë më e madhe
4. 3-5 herë më e madhe
5. 6-10 herë më e madhe
6. Mbi 10 herë më e madhe

P25. Në 6 muajt e kaluar, sa keni paguar për huanë ndaj totalit të të ardhurave? (një alternativë)

1. Deri në 20% të të ardhurave
2. 20-50% të të ardhurave
3. 50-80% të të ardhurave
4. Mbi 80% të të ardhurave

P26. Nëse ka ndryshuar shpenzimi për pagesën e huasë gjatë 6 muajve të kaluar, cili ka qenë shkaku?

- | | | |
|---------------------|---|--|
| | <i>(Mund të zgjidhen disa alternativa)</i> | <i>(Mund të zgjidhen disa alternativa)</i> |
| 1. Nuk ka ndryshuar | 2. Është rritur sepse:
2.1 është rritur norma e interesit;
2.2 janë shtuar kërkesa të tjera nga huadhënësi;
2.3 kanë rënë të ardhurat nga veprimtaria e biznesit;
2.4 të tjera _____(përcakto). | 3. Është ulur sepse:
3.1 është ulur norma e interesit;
3.2 është ulur vlera periodike e pagesës së huasë (p.sh. është ristrukturuar kredia);
3.3 ka ndryshuar forma e pagesës së huasë, duke i shtyrë detyrimet periodike;
3.4 janë rritur të ardhurat nga veprimtaria e biznesit;
3.5 të tjera ____përcakto____. |

P27. Nëse kostoja e shërbimit të huasë është rritur, si keni vepruar për ta përballuar? (më shumë se një alternativë)

1. Janë rritur çmimet e produkteve për klientët
2. Është shitur një pjesë e veprimtarisë së ndërmarrjes
3. Janë ulur shpenzimet e tjera
4. Janë përdorur rezerva të ndryshme
5. Është orientuar veprimtaria e ndërmarrjes drejt një fushe veprimi më fitimprurëse
6. Tjetër _____ (përcakto)

P28. Si prisni të ndryshojë pagesa totale e këstit të huasë në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

1. Nuk do të ndryshojë
2. Do të rriten
3. Do të ulen

P29. Si e vlerësoni në përgjithësi ngarkesën e borxhit?

RUBRIKA V. MARRËDHËNIA ME BANKAT DHE PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN
(REFERUAR EDHE BIZNESEVE JOHUAMARRËSE)

P30. A keni aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmuajorin e fundit?

1. Po, kam aplikuar (vijo me tabelën)

1.1. Kërkesa ime është miratuar	1.2. Kërkesa ime nuk është miratuar
1.1.1 Është ristrukturuar huaja ekzistuese	1.2.1. Është në proces
1.1.2 Kam marrë hua të re:	1.2.2. Nuk plotësoja kushtet e bankës sepse:
1.1.2.1 deri në 75% të vlerës së kërkuar;	1.2.2.1. nuk kisha aftësi paguese;
1.1.2.2 mbi 75% të vlerës së kërkuar.	1.2.2.2. projekti nuk ishte bindës;
	1.2.2.3. nuk kisha kolateral të mjaftueshëm;
	1.2.2.4. tjetër (specifiko)_____.

2. Jo, nuk kam aplikuar sepse:

- | | |
|--|--|
| 2.1. nuk e kam të nevojshme për veprimtarinë që kryej; | 2.3. mendoj që kërkesa ime nuk miratohet; |
| 2.2. më duket proces i vështirë; | 2.4. e kam më të lehtë të marr hua nga burime alternative. |

P31. Si do të veproni nëse nuk financoheni nga banka?

- Do të kërkoj në një bankë/institucion tjetër
- Do të shtyj në kohë planet për zgjerim të veprimtarisë
- Do të marr hua nga burime alternative

P32. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit procesin e marrjes së një huaje nga bankat në vend, në këto 6 muajt e fundit? (një alternativë)

- | | |
|----------------------|------------------------|
| 1. Shumë të thjeshtë | 4. Shumë të vështirë |
| 2. Normal | 5. Thuajse të pamundur |
| 3. Të vështirë | |

P33. Plotësoni elementet e mëposhtme me shifrat nga 1 në 5, sipas vështirësisë që secili element paraqet për ndërmarrjen tuaj në përfitimin e një kredie bankare, ku 1- "shkalla më e ulët e vështirësisë" dhe 5- "shkalla më e lartë e vështirësisë". (Plotësoni secilën alternativë)

- | | |
|--|---|
| 1. Paqartësia e kërkesave të bankës dhe procedura burokratike____ | 7. Gjatë jetës së kredisë, kushtet e saj ndryshohen në mënyrë jotransparente nga banka____ |
| 2. Kostoja e lartë financiare për të plotësuar kërkesat e bankës____ | 8. Nuk ekziston fleksibiliteti i nevojshëm midis bankës dhe kredimarrësit, për mënyrën e strukturimit dhe shlyerjen e kredisë____ |
| 3. Kushtet për garantimin e kredisë janë të paarsyeshme ____ | 9. Biznesi nuk arrin të plotësojë kërkesat normale të bankës për të marrë një kredi____ |
| 4. Procedura e miratimit të kredisë nuk është transparente ____ | |
| 5. Kredia në përgjithësi është e shtrenjtë____ | |
| 6. Struktura e kredisë nuk i përshtatet ciklit të veprimtarisë së biznesit____ | |

P34. Sa është mundësia që ndërmarrja juaj të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

- | | |
|-------------------------|-------------------|
| 1. Nuk ka asnjë mundësi | 4. Është e sigurt |
| 2. Ka pak mundësi | |
| 3. Ka shumë mundësi | |

P35. Sa të rëndësishme do t'i konsideronit marrëdhëniet me bankat për ecurinë e veprimitarisë së kompanisë suaj? (një alternativë)

1. Të domosdoshme

2. Të rëndësishme

3. Jo dhe aq të rëndësishme